

**VENDIM**  
**Nr. 451, datë 27.5.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 289, DATË 17.5.2006, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SË**  
**LEGALIZIMIT, URBANIZIMIT DHE INTEGRIMIT TË ZONAVE /NDËRTIMEVE**  
**INFORMALE (ALUIZNI)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 46, të ligjit nr. 9482, datë 16.2.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 2, e vendimit nr. 289, datë 17.5.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. ALUIZNI ka Drejtorinë e Përgjithshme në Tiranë dhe drejtori varësie në çdo qendër qarku. Përfshimisht, ALUIZNI ka në Fier dy drejtori, në Vlorë dy drejtori dhe në Tiranë pesë drejtori varësie”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Edi Rama**